



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1429/14 Prot.

Tiranë, më 28.05 2024

V E N D I M

Nr. 37 dt. 28.05 .2024

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË “REHABILITIMI
FIZIOTERAPEUTIK NË SPORT” SI DHE DRAFT RREGULLORES PËR KRYERJEN
E PRAKTIKËS, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT”**

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 2, pika b, nenin 33 paragrafi 3, nenin 37, nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 2 pika b, nenin 19, nenin 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr.1148 prot., datë 25.04.2024 “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e programit të dytë të studimit dhe miratimin e draft rregullores mbi kryerjen e praktikës, Master Profesional në “Rehabilitimi Fizioterapeutik në Sport”, në FSHR”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.05.2024,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”, në “Rehabilitimi Fizioterapeutik në Sport” si dhe draft rregullores për kryerjen e praktikës, në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit. (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1253/14 Prot.

Tiranë, më 02.05 2024

V E N D I M

Nr. 34 dt. 02.05 2024

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË “REHABILITIMI
FIZIOTERAPEUTIK NË SPORT” SI DHE DRAFT RREGULLORES PËR KRYERJEN
E PRAKTIKËS, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT”**

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 2, pika b, nenin 33 paragrafi 3, nenin 40 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 2 pika b dhe 25 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr.1148 prot., datë 25.04.2024 “Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e programit të dytë të studimit dhe miratimin e draft rregullores mbi kryerjen e praktikës, Master Profesional në “Rehabilitimi Fizioterapeutik në Sport”, në FSHR”, Rektorati në mbledhjen e datës 02.05.2024.

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”, në “Rehabilitimi Fizioterapeutik në Sport” si dhe draft rregullores për kryerjen e praktikës, në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit. (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTOR
Prof. Dr. Agron KAS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
DEKANATI

Nr. 1148/11 Prot.

Tiranë, më 25.04, 2024

Lënda: Për miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e programit të dytë të studimit, dhe miratimin e Draft-Rregullores mbi kryerjen e Praktikës, Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", në FSHR.

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS \angle
PROF. DR. AGRON KASA

I Nderuar Z. Rektor!

Mbështetur në Ligjin nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 33 pika 3, në rregulloren e UST-së neni 4, pika 4, bazuar në shkresën nr 1148 Prot, dt. 22.04.2024, "Kërkesë mbi ndryshimin e Rregullores të studimit dhe miratimin e Rregullores së kryerjes së e Praktikave të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", në FSHR", ardhur nga Departamenti i Kineziologjisë, njësi bazë në FSHR, përgjegjës i programit të dytë të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, po ju përcjellim (bashkëlidhur) për miratim rregulloret si më poshtë vijon:

1. Rregullore mësimore e programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", me ndryshime.
2. Rregullore mbi kryerjen e Praktikës për programin e ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport"

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DEKANI

Prof. Dr. Robert CINA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
DEPARTAMENTI I KINEZIOLOGJISË

Nr. 1148 Prot.

Tiranë, më 22/04/2024

Lënda: Kërkesë mbi ndryshimin e Rregullores së Programit të Studimit dhe miratimin e Rregullores së kryerjes së praktikave të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" në FSHR. ✓

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË REHABILITIMIT

PROF. DR. ROBERT ÇINA

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", bazuar në Urdhërin e hapjes me Nr. 446, Nr. 4873/2/Prot, datë 14.08.2023, për programin e studimit të ciklit të dytë, "Master Profesional" në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" në Universitetin e Sporteve të Tiranës si dhe bazuar në mbledhjen departamentit të datës 27.03.2024 po ju përcjellim kërkesën për ndryshimin e Rregullores së Programit të studimit dhe miratimit të rregullores së kryerjes së praktikave të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" në FSHR (formati bashkangjitur). Ndryshimet janë si më poshtë vijojnë:

Neni 13 "Organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale" (faqe 7)

1. Praktika profesionale do të zhvillohet pranë institucioneve sportive sipas marrëveshjeve që Universiteti ka me to.
2. Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të parë, sipas kohëzgjatjes së programit të studimit.
3. Studentët kanë detyrimin të kryejnë 100% të orëve të praktikës mësimore. Studenti

detyrohet të respektojë rregullat e institucionit pritës.

4. Gjatë kryerjes së praktikës mësimore, pedagogu përgjegjës që e drejton atë mban lidhje me institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës studenti përgatit një relacion për punën e kryer dhe dorëzon vlerësimin e bërë nga ana e institucionit ku ai ka kryer praktikën. Mbi bazën e këtyre dokumentave komisioni i ngritur në departament vlerëson studentin. Vlerësimi bëhet me notë.
5. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shluhen detyrimet për praktikën profesionale, departamenti mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në departament) mund ti japë të drejtën për rikryerjen e praktikës deri në fund të vitit akademik.

Neni 17 "Organizimi i Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar" (faqe 10)

1. Për të fituar diplomën në Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport studenti duhet të japë me sukses provimin përfundimtar, në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor.

2. Për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë, duke marrë kreditet e nevojshme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTUES I DEPARTAMENTI

Prof. Dr. Lindita AGOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
DEPARTAMENTI I KINEZIOLOGJISË

**Rregullore Mësimore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit
Master Profesional në
“Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport”**

Miratuar

Dekani

Prof. Dr. Robert ÇINA

Tiranë, 2024

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Rregullorja e Brendshme e programit të ciklit të dytë Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport vendos rregullat normative të funksionimit të programit dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e zhvillimit të programit.

Rregullorja përcakton misionin, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, bashkëpunëtorëve të jashtëm, raportet midis tyre, rregullat për pranimin e studentëve, mësimdhënien, kërkimin, praktikën, vlerësimin, diplomimin, publikimet, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka si qëllim të përcaktojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Programit të Ciklit të Dytë të Studimit Master Profesional. Ajo është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve.

Neni 3

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje kryhet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 71, të ligjit nr.80/2015, dt.22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor

në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr.41, datë 24.01.2018 për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë dhe ndryshimet sipas vendimit Nr.879, datë 18.12.2019. Gjithashtu kjo rregullore i referohet Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës 2020, Kreu VII, neni 72,73,75.

Neni 4

Subjektet

Subjektet e kësaj rregulloreje janë organet drejtuese, personeli akademik dhe administrativ, këshillat dhe komisionet e vlerësimit, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.

Neni 5

Statusi

1. Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport është program studimi i Ciklit të Dytë të Studimeve që ofrohet në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës
2. Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport zgjat 2 semestra akademikë me kohë të plotë, me 60 kredite (ECTS) në total.
3. Mbarëvajtja e veprimtarisë së programit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport, monitorohet nga autoritetet drejtuese përkatëse.

Neni 6

Misioni

Përgatitja e specialistëve / profesionistëve të fizioterapisë, që në përfundim të programit të studimit, të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e thelluara profesionale për të rehabilituar pacientë në ekipet sportive, në shërbime primare, sekondare dhe terciare me drejtim traumatologjik, ortopedik dhe kirurgjikal të bazuar në dëmtimet sportive.

Neni 7

Veprimtaria

1. Programi Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport ka për objektivi t'u japë pjesmarrësve aftësi profesionale në trajtimin fizioterapeutik të pacientit të traumatizuar, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave fizioterapeutike specifike për dëmtime sportive traumatike dhe kronike.
2. Programi ka për objektivi të rrisë kompetencat profesionale të fizioterapistëve nëpërmjet njohjes me trajtimet specifike në të specializimet si mjekësia sportive, patologjitë osteomuskulare, menaxhimin e dhimbjes, nutricionin sportiv, kontrollin fizioterapeutik në sport.

Neni 8

Parimet

1. Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport" e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike.
2. Liria akademike në mësimdhënien akademike nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve e metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor. Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet e programet mësimore të hartuara e miratuara nga strukturat akademike të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, për të gjitha lëndët/modulet që përfshihen në të.
3. Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese të infrastrukturës, si në aspektin e kërkesave edhe të rezultateve. Respektimi i parimit të cilësisë ka për qëllim realizimin e vlerësimit të brendshëm (të vetëvlerësimit), të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin dhe përparimin e cilësisë së programit të cilkit të dytë të studimit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport.

KREUII

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT TE STUDIMIT

"Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport"

Neni 9

Kompetencat e Dekanatit të Fakultetit

1. Propozon planin mësimor dhe strukturën e studimeve dhe ia kalon për miratim Senatit Akademik.
2. Ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit të programit.
3. Shqyrton në mënyrë përfundimtare dhe merr vendim në lidhje me ankesat e aplikantëve, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e ankimit fillestar të aplikantit.
4. Shqyrton në mënyrë përfundimtare kërkesat e studentëve që apikojnë për Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport.

Neni 10

Personeli akademik

1. Personeli akademik që zhvillon mësim në Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport, duhet të jetë me titull të paktën doktor.
2. Pedagogët e huaj pranohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe.
3. Personeli akademik i ftuar (me kontrate të përkohshme) propozohen nga Dekani dhe miratohen nga Senati.
4. Për çdo semestër akademik, secili pedagog sipas pikës 3 të këtij neni, nënshkruan një kontratë pune ku janë parashikuar detyrimet e pedagogut, angazhimet në Programin e studimit te ciklit të dytë Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport.
5. Syllabuset/Programet e lëndëve duhet të dorëzohen në fillim të vitit akademik në Departament dhe në Dekanat. Syllabuset/Programet duhet të jenë të firmosura nga titullari i Lëndës, Përgjegjësi Departamentit dhe Dekani.
6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pedagogëve:
 - a. Të përdorin të gjitha mjediset dhe pajisjet e institucionit për veprimtari në dobi të zhvillimit të programit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport
 - b. Të marrin pjesë në komisione dhe veprimtari të ndryshme.
 - c. Të kualifikohen në kuadrin e projekteve të këtij programi dhe jo vetëm.
 - d. Të zbatojnë kontratën e punës.
 - e. Të zbatojnë Rregulloren e Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik ne Sport pas miratimit të tij.

- f. Të bashkëveprojnë në mënyrë profesionale, qytetare me kolegët, studentët dhe bashkëpunëtorët.
- g. Të realizojnë programin mësimor sipas kërkesave të paracaktuara.
- h. Të krijojnë një klimë bashkëpunimi me studentët dhe kolegët.
- i. Të vlerësojnë studentët në mënyrë profesionale dhe në kohën e parashikuar.

Neni 11

Specialisti i departamentit që mbulon programin

1. Mban përgjegjësi për komunikimin shkresor në funksion të programit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport me organet drejtuese, personelin akademik, me studentët, me bashkëpunëtorët e institucionit.
2. Bën organizimin teknik të mbledhjeve dhe mban procesverbalin e mbledhjeve.
3. Organizon dhe ndihmon stafin akademik në përgatitjen e materialeve mesimore për zhvillimin e procesit mësimor të programit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.
4. Merr në dorëzim korrespondencën dhe materiale të tjera që vijnë në adresë të organeve drejtuese të programit të studimeve Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.
5. Arkivon dokumentacionin e programit në fjalë.
6. Ndihmon departamentin në ecurinë e procesit mësimor në drejtim të respektimit të strukturës mesimore, të orarit të mësimit, të provimeve; ecurinë e praktikës, të procesit të temës e përmbajtjen e dokumentacionit përkatës të këtyre proceseve.
7. Ndjek publikimin dhe afishimin e strukturës mesimore, orarit të mësimit, datat e provimeve, datat e praktikës, të provimit përfundimtar dhe lajmërimi për veprimtari të ndryshme.

Neni 12

Struktura e studimeve

1. Programi i studimit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport realizohet në 2 semestra akademike, në përfundim të programit studenti fiton 60 kredite (ECTS).

2. Programi i studimit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Rehabilitimit, si dhe në ambientet e strukturave bashkëpunuese.

Neni 13

Organizimi dhe vlerësimi i praktikave profesionale

1. Praktika profesionale do të zhvillohet pranë institucioneve sportive sipas marrëveshjeve që Universiteti ka me to.
2. Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të parë, sipas kohëzgjatjes së programit të studimit.
3. Studentët kanë detyrimin të kryejnë 100% të orëve të praktikës mësimore. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit pritës.
4. Gjatë kryerjes së praktikës mësimore, pedagogu përgjegjës që e drejton atë mban lidhje me institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës studenti përgatit një relacion për punën e kryer dhe dorëzon vlerësimin e bërë nga ana e institucionit ku ai ka kryer praktikën. Mbi bazën e këtyre dokumentave komisioni i ngritur në departament vlerëson studentin. Vlerësimi bëhet me notë.
5. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shluhen detyrimet për praktikën profesionale, departamenti mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në departament) mund ti japë të drejtën për rikryerjen e praktikës deri në fund të vitit akademik.

Neni 14

Format e mësimit

1. Veprimtaria akademike realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike klinike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikës.
2. Elementët kryesorë të organizimit të studimit janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, esetë, praktikat mësimore e profesionale, provimet (testimet) e ndërmjetme dhe përfundimtare të kursit.
3. Çdo njësi kryesore mund të përcaktojë edhe elementë të tjerë të punës mësimore, veçanërisht në fushën e kontrollit të dijeve.
4. Leksionet, seminarët/ushtrimet, praktikat mësimore e profesionale, laboratorët etj, zhvillohen në grupe mësimore me numër studentësh sipas përcaktimeve në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
5. Kohëzgjatja e seancave mësimore (në minuta) është sipas përcaktimeve të akteve nënligjore.
6. Ndarja e studentëve në grupe bëhet nga sekretaria mësimore dhe me miratim të Dekanit fiksuar në rregjistrat e kurseve në të cilat pasqyrohet pjesëmarrja dhe zhvillimi i orëve të mësimit nga pedagogët sipas orarit dhe në përputhje me programin përkatës dhe ngarkesën mësimore të miratuar.

Neni 15

Frekuentimi

Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75% për seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat mësimore dhe në masën 50% për leksionet.

- a. **Frekuentimi i leksioneve:** Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 50%. Në përputhje me specifikat e veta, çdo fakultet në rregulloren e tij të brendshme, mund të përcaktojë lëndë të cilat mund të kenë një kufi tjetër frekuentimi. Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 50% të tyre, ai nuk klasifikohet dhe përsërit lëndën në vitin e ardhshëm. Në këtë rast studenti është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimit në vitin pasardhës me të njëjtën detyrë frekuentimi.
- b. **Frekuentimi i seminareve:** Është i detyrueshëm në masën 75%. Kur studenti ka marrë pjesë në 50-75% nuk ka të drejtë të futet në provimin e radhës e konsiderohet mbetës, por

kalon në sezonin e vjeshtës. Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 50% të tyre, ai nuk klasifikohet dhe përsërit lëndën në vitin e ardhshëm. Në këtë rast studenti është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimin në vitin pasardhës me të njëjtën detyrë frekuentimi.

- c. **Frekuentimi i ushtrimeve (mësimi praktik):** Është i detyrueshëm në masën 75%. Kur studenti ka marrë pjesë në 65-75% nuk ka të drejtë të futet në provimin e radhës por kalon në sezonin e vjeshtës. Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 65% të tyre, ai nuk klasifikohet dhe përsërit lëndën në vitin e ardhshëm. Në këtë rast studenti është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimin në vitin pasardhës me të njëjtën detyrë frekuentimi.
- d. **Frekuentimi i punëve laboratorike:** Është i detyrueshëm në masën 75%. Kur studenti nuk ka frekuentuar deri në 25% të punëve laboratorike të çdo lënde, i shlyen ato në dy javët e fundit të vitit në vazhdim, apo semestrit kur lënda është semestrale. Nëse ka frekuentuar më pak se 75% të tyre, i shlyen ato në vitin pasardhës. Në këtë rast studenti është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimin në vitin pasardhës me të njëjtën detyrë frekuentimi.

K R E U I I I

DIPLOMIMI I STUDENTËVE

Neni 16

Kërkesat specifike për diplomimin e studentit

1. Në përfundim të kursit të plotë të programit të studimit "Master Profesional" në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", studentët kanë të drejtë të diplomohen në fushën e rehabilitimit në sport.
2. Studimet e ciklit të dytë "Master Profesional në "Rehabilitimi Fizioterapik në Sport", përmbillen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master Profesional në "Rehabilitimi Fizioterapik në Sport".
3. Studenti nuk mund të futet në provimin final pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.
4. Studenti, para provimit të përgjithshëm përfundimtar duhet të ketë shlyer të gjitha

detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin.

Neni 17

Organizimi i Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar

1. Për të fituar diplomën në Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport studenti duhet të japë me sukses provimin përfundimtar, në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor.
3. Për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë, duke marrë kreditet e nevojshme.

Neni 18

Ndërprerja e studimeve

Studenti mund të ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit vetëm për këto raste:

1. Kur sëmuret për periudha të gjata, të dokumentuara me raport komisioni mjeko-ligjor.
2. Në raste fatkeqësish familjare e në kushte ekonomike të vështira, të dokumentuara këto nga zyrat përkatëse të pushtetit lokal.
3. Në rastet kur studenti ndjek studime e kualifikime në institucione të tjera të arsimit të lartë vendas ose të huaj, me miratim nga njësia kryesore.

KREU VI

VLERËSIMI I STUDENTIT

Neni 19

Procedura dhe kriteret e vlerësimit

1. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve.
2. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:
 - a. me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar
 - b. me detyra kursi
 - c. i bazuar në kombinimin e formave të mësipërme të vlerësimit.
3. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave, ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 ajo maksimale.
4. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Notat nga 5 e lart janë kaluese.
5. Me përfundimin me sukses të gjitha detyrimeve të përcaktuara në planin mësimor të programit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport, studenti pajiset me diplomë.
6. Sistemi i vlerësimit si më poshtë:
Vendosja e notave bazuar në pikët e grumbulluara kryhet sipas referencave të mëposhtme:

1	Nota 4 (katër)	F	0 – 44 % e pikëve
2	Nota 5 (pesë)	E	45 – 54 % e pikëve
3	Nota 6 (gjashhtë)	D	55 – 64 % e pikëve
4	Nota 7 (shtatë)	C	65 – 74 % e pikëve
5	Nota 8 (tetë)	B	75 – 84 % e pikëve
6	Nota 9 (nëntë)	B+	85 – 94 % e pikëve
7	Nota 10 (dhjetë)	A	95 – 100 % e pikëve

Neni 20

E drejta për të hyrë në provim

Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde kur ka shlyer detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor, si dhe detyrimet financiare.

Neni 21

Zhvillimi i provimeve

1. Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e tyre shpallen që në fillim të vitit akademik.
2. Në rast pamundësie të jashtëzakonshme të zhvillimit të provimit ose të prezantimit ditën e caktuar, Departamenti, sipas propozimit të pedagogut të lëndës, propozon Dekanatinë kaktimin me urdhër me shkrim të një date tjetër të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve dhe komisionit.

21.1 Afatet e Provimeve

- a. Provimet zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik.
- b. Ndryshimet e mundshme në kalendar bëhen të paktën një muaj para fillimit të sezonit të provimeve.
- c. Datat e provimeve propozohen nga sekretaria mësimore në bashkëpunim me departamentet dhe miratohen nga dekani.
- d. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë e të dytë, për fitimin e diplomës si detyrime përmbyllese realizohet me provim përfundimtar, sipas specifikave të njëjësive kryesore dhe të përcaktuara në rregulloren e brendshme të tyre.
- e. Afatet e përcaktuara për provimet janë të detyrueshme për zbatim si për lektorët, ashtu dhe për studentët.
- f. Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde brenda një sezoni.

21.2 Mënyra e zhvillimit të provimeve të sezonit

- a. Provimet zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Për shkaqe të forcës madhore apo shkaqe të tjera, dekani urdhëron datën dhe orën e re të zhvillimit të provimit, duke njoftuar studentët të paktën tre ditë para.
- b. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga së paku dy pedagogë. Komisioni kryesohet nga titullari i lëndës. Nëse lëndën e kanë zhvilluar pedagogë të jashtëm, në komision njëri duhet të jetë pedagog i brendshëm. Komisioni ndjek zhvillimin e provimit dhe ka përgjegjësinë për mbarëvajtjen e provimit. Anëtarët e komisionit të

provimit mbikëqyrin zhvillimin korrekt të provimit gjatë gjithë kohës nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.

- c. Nëse njëri nga pedagogët nuk mund të marrë pjesë në provim ose kur përgjegjësi i departamentit e gjykon, ai përcakton pedagogun që do ta zëvendësojë.
- d. Kohëzgjatja e një provimi me shkrim ose me gojë është jo më shumë se 3 orë.
- e. Rezultatet e vlerësimit përfundimtar u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet afishimit të rezultateve nga komisioni në përfundim të provimit me shkrim brenda 10 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Më pas procesverbalet e provimit të plotësuara me notat përfundimtare nga komisioni, dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 3 ditëve nga data e afishimit të rezultateve përfundimtare.

21.3 Përmirësimi i notës

(Sipas nenit 59 të rregullores së UST-së)

- a. Studenti ka të drejtën e përmirësimit të notës brenda vitit akademik, deri në tre lëndë nga detyrimet e atij viti. Kanë të drejtë të përmirësojnë notën ata studentë që kanë deri dy detyrime të pashlyera, në total.
- b. Për përmirësim note, studenti provohet vetëm njëherë në sezonin e vjeshtës, duke mbetur në fuqi nota me të cilën studentin vlerësohet në këtë provim përmirësimi. Për studentët e vitit të diplomimit përmirësimi i notës bëhet në sezonin e riprovimeve para diplomimit. Kanë të drejtë të përmirësojnë notën vetëm studentët që kanë vetëm një detyrim të pa shlyer.
- c. Studenti vlerësohet në provimin për përmirësimin e notës vetëm për sasinë e pikëve që përmbledhin provimet e ndërmjetme e provimi përfundimtar. Ndërsa pikët e fituara në vazhdimësinë e zhvillimit të lëndëve sipas syllabit, që përbën 20 pikë, studentin i mbart dhe nuk mund të ndryshohen.
- d. Kërkesa për përmirësim note i paraqitet dekanit në fillim të sesionit të vjeshtës. Në bazë të vendimit që merr dekani, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse duke bashkërenduar punën me përgjegjësin e departamentit.

Neni 22

Komunikimi i vlerësimeve

1. Vlerësimet për lëndë të veçanta komunikohen nga Sekretaria mësimore ose nëpërmjet sistemit informatik të FSHR.
2. Dhënia e vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit.

Neni 23

Dokumentimi i vlerësimeve

Vlerësimet përfundimtare të lëndës/modulit dokumentohen në procesverbalin e provimit dhe në Regjistrin e notave.

Neni 24

Modalitetet e diplomës

1. Diplomat për ciklin e dytë shoqërohen me Suplementin e Diplomës.
2. Suplementi i Diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan në veçanti natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës.
3. Përmbajtja dhe forma e diplomës është e përcaktuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
4. Përmbajtja dhe forma e Diplomës, Suplementit të Diplomës janë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
5. Studentët, që kanë plotësuar detyrimet e një programi të formimit të vazhduar ose pjesë të një programi studimi pajisen me diplomat ose certifikatat përkatëse, që janë dokument zyrtar.
6. Universiteti pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.
7. Diploma plotësohet me shkrim të qartë dhe me bojë teknike. Ajo nënshkruhet nga dekani i njësisë kryesore dhe rektori i UST-s. Për secilin prej tyre shënohet emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet shoqërohen me vulë.

8. Respektivisht sipas ciklit lëshohet diploma: Cikli i dytë i studimeve: Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport.

KREU V

PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 25

Politika e pranimit

1. Çdo vit akademik, për të ndjekur Programin Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport, pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Republika e Maqedonisë së Veriut, Serbia e Mali i Zi dhe nga vende të tjera pasi kandidatët kryejnë procedurën e njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
2. Programi Master profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport synon të jetë një program për të gjithë aplikantët që kanë përfunduar më sukses, Kandidati që aplikon në këtë program studimi, duhet të zotërojë minimalisht:
 - Diplomë Bachelor në Shkenca Rehabilitimi, Fizioterapi, Fusha e veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit apo diploma të ngjashme me to.
 - Diplomë në mjekësi të përgjithshme.
 - Diplomë të universiteteve të tjera brenda ose jashtë vendit të njëvlefshme me diplomat e sipërpërmëndura
3. Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës që nënkupton vlerësimin tërësor të treguesve të kandidatit.
4. Kriteret specifike akademike për përzgjedhjen e kandidatëve në programin e studimit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport, përcaktohen dhe miratohen cdo fillim viti akademik nga departamenti dhe organet e tjera kolegjiale në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Këto kritere bëhen publike në çështjen e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit për të gjithë të interesuarit.
5. Hapja e aplikimit për pranim në programin Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport bëhet publike pranë çështjes së Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit të Sporteve, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 26

Procedurat e pranimit

1. Pranimi i dokumentacionit
 - a. Grumbullimi i dosjeve fillon me hapjen e procesit të aplikimit
 - b. Të gjitha dokumentet për konkurrim duhen dorëzuar nga vetë i interesuari në sekretarinë mësimore.
2. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve dhe e komunikimit të vendimit:
 - a. Procesi i shpalljes së fituesve përfundon sipas afateve të parashikuara në udhëzimet përkatëse për to.
 - b. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, Komisioni i Vlerësimit, ngritur me urdhër të dekanit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, përzgjedh kandidatët fitues.
3. Studentët e shpallur fitues njoftohen elektronikisht në faqen zyrtare të Fakultetit për procedurat e regjistrimit, afatet, pagesën etj. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim përcaktohet nga aktet nënligjore dhe publikohet në faqen zyrtare të UST.
4. Aplikantët jo fitues mund të bëjnë kërkesë me shkrim drejtuar Dekanatit, për rishqyrtim të dokumentacionit të tyre.
5. Aplikantët jo fitues mund të tërheqin dokumentacionin përkatës përkundrejt kërkesës, mbështetur në aktet nënligjore.

KREU VI

STUDENTËT

Neni 27

Statusi i studentit

1. Kandidati fitues ka të drejtë të ndjekë studimet në programin Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport për të cilin konkurroi nëse regjistrohet në Sekretarinë Mësimore brënda afateve të parashikuara. Me regjistrimin ai fiton statusin e studentit dhe të gjitha të drejtat që burojnë prej tij.
2. Statusi i studentit përfundon me marrjen e diplomës, me çrregjistrimin ose me përjashtimin e studentit nga programi i studimit Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport për arsye të shkeljes së akteve normative përkatëse.

Neni 28

Të drejtat dhe detyrat e studentëve

28.1 Të Drejtat e Studentëve

Studenti ka të drejtë:

1. Të ndjekë leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tij
2. Të përdorë mjedise si biblioteka, salla kompjuterash, terrenet e sallat sportive si dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga universiteti
3. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese, Senat Akademik, Këshill Administrimi të UST-s, në këshillat e fakulteteve/instituteve, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Universitetit
4. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit, kur plotëson kushtet e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të Senatit e në marrëveshjet ndërshtetërore ose ndëruniversitare
5. Të organizohet në shoqata të ndryshme jo politike, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse
6. Të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të Universitetit.

28.2 Detyrimet e Studentëve

Studenti është i detyruar:

1. Të njohë me hollësi rregulloren e fakultetit/institutit e detyrimet që lindin dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre; në të kundërt shkolla nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre
2. Të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Ligji për Arsimin e Lartë, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Statuti i Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe kjo Rregullore
3. Të respektojë Kodin e Etikës të UST-s dhe fakultetit/institutit
4. Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve
5. Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të shkollës nga ana e tij, dëmi material që ai mund të ketë bërë, zhdëmtohet në masën që e gjykon njësia kryesore.

Neni 29

Tarifa e shkollimit

1. Tarifa e shkollimit për Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport propozohet nga departamenti që mbulon programin, dhe pas miratimit në organet kolegjiale përkatëse (Dekanat, Senat akademik dhe Bordi i Administrimit) njoftohet për të gjithë aplikantët.
2. Studenti është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës së shkollimit në datën e caktuar nga institucioni.
3. Secili kandidat që aplikon në programin Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport, paguan tarifën e aplikimit, mandat pagesa e të cilit i bashkëlidhet dosjes së aplikimit. Kjo tarifë është e pakthyeshme për kandidatët që nuk fitojnë.

KREU VII

DIPLOMIMI I STUDENTËVE

Neni 30

Kërkesat specifike për diplomimin e studentit

1. Në përfundim të kursit të plotë të programit të studimit "Master Profesional" në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", studentët kanë të drejtë të diplomohen në fushën e rehabilitimit.
2. Studimet e ciklit të parë "Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport", përmbyllen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master Profesional në Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport".
3. Studenti nuk mund të futet në provimin final pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.
4. Studenti, para provimit të përgjithshëm përfundimtar duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin.

Neni 31

Organizimi i Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar

1. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Master Profesional në “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport”.
2. Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit organizon konsultime me studentët për tematika të ndryshme të programit të provimit sipas një grafiku të miratuar prej saj dhe të shpallur në mjediset publike të universitetit.
3. Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë efektivë, të fushave që mbulon programi i provimit.
4. Anëtarët e komisionit propozohen nga njësitë bazë të cilët mbulojnë lëndët e përfshira në provimin e përgjithshëm, dhe miratohen nga drejtuesi i FSHR-së.
5. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat/lëndët që përfshihen në programin e provimit.
6. Njësitë bazë të përfshira në provimin e përgjithshëm përfundimtar hartojnë fondin e pyetjeve dhe i depozitojnë në Departament të paktën një javë para fillimit të sesionit të provimit.
7. Fondi i pyetjeve duhet të jetë rreth 10 herë më i madh se numri përkatës i pyetjeve që përmban teza në fushën përkatëse.
8. Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar kompozohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe.
9. Provimi organizohet me shkrim dhe me gojë.
10. Vlerësimi i studentit bëhet nga komisioni me notë.
11. Rezultatet e provimit të përgjithshëm përfundimtar duhet të jepen brenda afateve të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme të UST-së.

Neni 32

Detyrimet përbyllëse / Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar dhe Diplomimi

1. Detyrimet përbyllëse / Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar rregullohen me anë të rregulloreve të UST dhe rregulloreve të UST dhe FSHR
2. Provimi i përgjithshëm përfundimtar organizohet në tre sesione; verë, vjeshtë dhe dimër, në përputhje me strukturën akademike si dhe duke respektuar procedurën e përshkruar në rregulloren e përgjithshme të UST-së, rregulloren e provimeve të UST-së dhe rregulloren e FSHR-së.

3. Komisioni i diplomimit përbëhet nga 3-5 (pesë) anëtarë.
4. Provimi përfundimtar i diplomimit organizohet me një fazë:
Faza 1. Testim me gojë
5. Testimi me gojë do të përmbajë dy pyetje të dy rasteve klinike nga fusha të ndryshme të fizioterapisë dhe rehabilitimit, sipas moduleve dhe temave të përcaktuara në programin që është aprovuar dhe që u është bërë me dije studentëve, nëpërmjet komunikimit me ta si dhe publikimit në websiten e UST-së dhe FSHR-së.
6. **Mënyra e vlerësimit:**
 - ✓ 100% testimi me gojë
 - ✓ 100% x pikët me gojë = pikët e fitura
7. Nota e testimit me gojë është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit.
8. Kur studenti vlerësohet me notë pozitive, FSHR e pajis studentin e sapodiplomuar me diplomën "Master Profesional" në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" të shoqëruar me suplementin e saj.
9. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UST, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
10. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në provimin e përgjithshëm përfundimtar, ai mund të rihyjë në provim brenda një afati kohor të caktuar, por pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në komizën ligjore në fuqi.
11. Gjatë periudhës kohore maksimale të përcaktuar në komizën ligjore në fuqi nga koha e përfundimit të studimeve të plota, diplomanti ka të drejtë të hyjë në provim deri në tre herë.
12. Nëse në të tre rastet diplomanti është vlerësuar nga komisioni me notë negative ose ai nuk paraqitet për të kryer provimin e përgjithshëm përfundimtar brenda afateve maksimale, atëherë studenti humbet të drejtën e diplomimit.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33

Kompetencat e Koordinatorit të programit

1. Është përgjegjës për administrimin e të gjithë procesit të studimeve Master Profesional.
2. Shqyrton çdo kërkesë me shkrim të studentëve, të depozituar në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit.
3. Raporton për respektimin e standardeve të cilësisë tek Dekani dhe Struktura përgjegjëse e sigurimit të cilësisë në UST.

Neni 34

Punë shkencore –kërkimore

1. Puna kërkimore –shkencore është pjesë përbërëse e procesit mësimor përmes të cilës studenti krijon qasje kritike ndaj çështjeve profesionale si dhe fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.
2. Studenti mund të përfshihet në punë kërkimore shkencore në kuadër të projekteve shkencore të departamentit.

Neni 35

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë Master Profesional në "Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport" të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit dhe nga Rektori i UST-së.

Neni 36

1. Kjo rregullore mund të përsoset e të korrigjohet, në përputhje me zhvillimet më të reja në aspektet teorike dhe praktike të fushës së Fizioterapisë.
2. Të drejtën e interpretimit të kësaj Regulloreje e ka Dekani i Fakultetit Shkencave të Rehabilitimit dhe Rektori.

Neni 37

Te tjera

1. Në rast mospërputhje ndërmjet kësaj Rregulloreje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Sporteve të Tiranës, do të zbatohen dispozitat e këtyre të fundit.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi, menjëherë pas miratimit të saj nga organet përkatëse.

DREJTUES DEPARTAMENTI

Prof. Dr. Lindita AGOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
DEPARTAMENTI I KINEZIOLOGJISË

RREGULLORE MBI KRYERJEN E PRAKTIKËS

PROGRAMI I CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË
"REHABILITIM FIZIOTERAPEUTIK NË SPORT"

MIRATOI

DEKANI

Prof. Dr. Robert ÇINA

MIRATOI

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

Prof. Dr. Lindita AGOLLI

_____. 2024

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 05.10.2015, "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST.

Neni 2
Objekti i Rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për kryerjen e Praktikës nga studentët e Masterit Professional, FSHR, UST.

Neni 3
Qëllimi i praktikës

Praktika synon përvetësimin efektiv të njohurive tekniko-praktike dhe etike të profesionit. Praktika profesionale përfaqëson thelbin e përgatitjes profesionale të studentëve në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit dhe mbetet një modalitet themelor në zhvillimin e kompetencave fizioterapeutike, marrëdhënieve dhe sjelljeve, gjykimit diagnostik dhe mendimit kritik.

Qëllimi i praktikës është:

- Zhvillimi i kompetencave profesionale: praktika lehtëson përpunimin dhe integrimin e informacionit, njohurive dhe përvojës.
- Zhvillimi i identitetit dhe përkatësisë profesionale: praktika promovon përparimin dhe tejkalimin e idealizuar të profesionit dhe ndihmon studentët të afirmojnë zgjedhjen e bërë.
- Promovimi i socializimit të hershëm në punë: përmes praktikës studenti bie në kontakt me kontekstet organizative dhe fillon të kuptojë dimensionet funksionale, hierarkike, relacionale dhe ndërprofesionale të shërbimeve, lejon të vlerësojë vlerat, aftësitë dhe sjelljen e tyre të punës.

KREU II ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PRAKTIKËS

Neni 4 Fusha e zbatimit

Praktika profesionale realizohet në semestrin e dytë të vitit të parë, sipas kohëzgjatjes së programit të studimit. Praktika do të zhvillohet pranë qendrave spitalore universitare, klinikave të specializuara për rehabilitimin dhe fizioterapinë dhe institucioneve sportive sipas marrëveshjeve që Universiteti ka me to, si dhe nën supervizionin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës.

Praktika në klinika, mjedise spitalore apo mjedise sportive lejon që studenti të përballet me situata unike dhe komplekse, menaxhimi i të cilave nuk mjaftohet vetëm përmes qasjeve teorike, por gjithashtu vëzhgimi, të menduarit kritik dhe reflektimi mundëson kuptimin dhe zgjidhjen e tyre.

Praktika i ofron studentit jo vetëm mundësinë e të mësuarit për të vepruar, por edhe mundësinë e të menduarit duke vepruar, përfaqësimin ndaj problemeve, për të menduar në mënyrë të thelluar dhe kritike rreth asaj që ndesh në përvojën me pacientë realë.

Neni 5 Detyrimet e studentit

Aktiviteti kryesor i studentëve gjatë praktikës është të mësuarit dhe jo vetëm të kryerit. Procesi i trajnimit gjatë praktikës duhet të lehtësojë integrimin e teorisë dhe praktikës dhe duhet të ndihmojë studentët të jenë nxënës aktivë dhe profesionistë të ardhshëm reflektues, të aftë të përballen me ndryshime.

Studenti duhet të frekuentojë orët e praktikës në masën 100% dhe detyrohet të respektojë rregullat e institucionit pritës.

Neni 6 Procedura e kryerjes së praktikës

Praktikën duhet ta zhvillojnë të gjithë studentët e regjistruar në vitin akademik ku parashikohet ajo, në bazë të programit mësimor.

6.1 Mbikëqyrja Praktika ushtrimore dhe klinike është një përvojë e mbikëqyrtur. Qëllimi është që studenti të lejojë të arrijë dhe të mbajë në mënyrë krijuese mësimin cilësor dhe të rrisë ndjenjën e përgjegjësisë përmes mbështetjes së ofruar nga një ose më shumë profesionistë me përvojë.

6.2 Organizimi i praktikës. Frekuentimi i studentit në aktivitetet e praktikës është 100% i detyrueshëm për të gjitha ECTS e përcaktuara në planin mësimor të programit të studimit,

që duhet të vërtetohen dhe vlerësohen.

Objektivat e përgjithshme të praktikës, listuar më poshtë, përcaktohen nga një raport specifik i praktikës, që përfshin gjithë kursin e studimit, i cili paraqet udhëzuesin referencë për të gjithë përvojën e trajnimit praktik. Bazuar në objektivat e përgjithshme të praktikës synohet që gjatë praktikës studentët të:

- Administrojnë testime të aftësive funksionale të muskujve, nervave dhe artikulacioneve për të identifikuar dhe vlerësuar problemet fizike të pacientëve;
- Përcaktojnë qëllimet e trajtimit në bashkëpunim me pacientin;
- Dizenjojnë programe trajtimi për të lehtësuar dhimbjen fizike, përforcuar muskujt, rikthyer mobilitetin e artikulacioneve dhe për të përmirësuar ekuilibrin;
- Krijojnë programe për të përmirësuar funksionet kardiovaskulare dhe respiratore;
- Kryejnë zhvillimin, implementimin dhe monitorimin e programeve dhe trajtimeve, duke përdorur vetitë terapeutike të aktivitetit fizik, nxehtësisë, të ftohtit, masazheve, hidroterapisë, elektroterapisë, dritës infra të kuqe e ultraviolet dhe ultratingujve për trajtimin e pacientëve;
- Instruktojnë pacientët dhe familjarët e tyre për procedurat që duhen vazhduar jashtë-ambienteve klinike;
- Regjistrojnë historikun e të dhënave mjekësore të pacientit;
- Konsultohen me historikun e të dhënave mjekësore të pacientit për të kryer diagnostikimin e mëtejshëm;
- Monitorojnë përgjigjen e pacientëve ndaj trajtimeve;
- Ndajnë informacionin me profesionistë të tjerë të shëndetit për të siguruar një kujdes të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës të pacientit;
- Kryejnë zhvillimin dhe implementimin e programeve të promovimit të shëndetit për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve fizike të zakonshme, për pacientët dhe komunitetin;
- Kryejnë kërkime në fizioterapi dhe rehabilitim;
- Informohen mbi teknikat dhe procedurat e reja të zbuluara në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit.

Neni 7

Strukturat Përgjegjëse

Struktura përgjegjëse për kryerjen dhe ndjekjen e praktikës janë:

- a) Autoritetet drejtuese të Departamentit të Kineziologjisë dhe të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit
- b) Pedagogu i ngarkuar për ndjekjen e praktikës (koordinatori didaktik)
- c) Mentori profesional

Koordinimi i aktiviteteve

- **Koordinatori didaktik:** Profesionist me aftësi të përparuara si në fushën pedagogjike ashtu edhe në atë specifike profesionale, i caktuar nga institucioni, me kohë të plotë, i cili bashkëpunon në organizimin dhe menaxhimin e praktikave cilësore, hartimin dhe menaxhimin e vlerësimit të aftësive profesionale. Mban dhe kujdeset për marrëdhëniet me stafin e shërbimeve në institucionet pritëse për të arritur objektivat e praktikës. Ai

aktivizohet për takime me studentët dhe mentorët profesionalë sipas nevojave të identifikuar ose raportuara gjatë zhvillimit të praktikës.

- **Mentori profesional** i praktikës është profesionist në fushën shëndetsore dhe/ose sportive si mjek/ fizioterapist/ rehabilitues sportiv në shërbimin e të cilit studentët kryejnë praktikën, mbikëqyr grupin e studentëve në njësinë përkatëse në përputhje me objektivat e trajnimit të përcaktuara në planin mësimor; udhëzon studentin gjatë aktiviteteve të kujdesit fizioterapeutik dhe i delegon këto detyra edhe tek bashkëpunëtorët me përvojë të dëshmuar profesionale. Garanton sigurinë e studentit dhe siguron që fizioterapistët të informohen dhe të japin aprovimin e tyre për t'u ndihmuar nga studentët.

Dokumentacioni

- Për të regjistruar frekuentimin, studenti duhet të paraqitet çdo ditë dhe frekuentimi i praktikës duhet të miratohet nga Mentori profesionist.
- Koordinatori didaktik do të kryejë kontrolle të rastit.

KREU III

DETYRIMET E INSTITUCIONIT DHE TË MENTORIT

Neni 8

Detyrimet e Institucionit

Detyrimet e Universitetit të Sporteve dhe të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit janë realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e praktikave pranë qendrave spitalore universitare, klinikave private të rehabilitimit dhe fizioterapisë, si dhe pranë skuadrave sportive/institucioneve sportive. Marrëdhëniet midis UST, FSHR dhe këtyre institucioneve pritëse rregullohen me marrëveshje të dakortësuara dy palëshe.

Institucionet pritëse dhe mentorët profesionistë duhet të sigurojnë që studenti të kryejë me sukses praktikën nëpërmjet:

- Krijimit të mundësive për studentin të ndjekë trajtimin fizioterapeutik dhe rehabilitues të pacientëve.
- Njohjes së studentit me rregulloret e institucionit.
- Plotësimit të fletës së frekuentimit të studentit gjatë praktikës së mbikëqyrur nga mentorët profesionistë.

Neni 9

Detyrimet e studentit gjatë periudhës së kryerjes së praktikës

Studenti është i detyruar të kujdeset për imazhin e tij personal dhe të roleve duke respektuar rregullat e mëposhtme të sjelljes:

- Ndalohet largimi nga praktika gjatë orarit të shërbimit.
- Studenti është përgjegjës për uniformën, e cila nuk duhet të personalizohet ose të vishet me dekor por duhet të jetë e pastër, e rregullt, e plotë dhe me etiketë identifikimi.
- Në praktikë veshja personale duhet të jetë gjithmonë etike dhe dinjitoze.

- Është e ndaluar të vishen bizhuteri të çdo madhësie të vendosura në zonat të dukshme për pacientët dhe pa respekt, të cilat nevojiten për sigurinë personale dhe për të shmangur transmetimin e infeksioneve spitalore te pacientët me të cilët punohet. Ora e dorës duhet të hiqet në fillim të orarit të praktikës ose rekomandohet përdorimi i orës së xhepit.
- Përdorimi i kozmetikës dhe parfumeve duhet të jetë i kufizuar.
- Flokët duhet të mblidhen mirë ose të shkurtra për të dy gjinitë.
- Thonjtë të shkurtër dhe pa manikyr dhe /ose xhel.
- Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale është i detyrueshëm në praktikat, sipas udhëzimeve të strukturës përkatëse.
- Gjatë praktikës përdorimi i telefonave celularë duhet të jetë i kufizuar dhe sipas konteksteve specifike të përshtatet me dispozitat e shërbimit spitalor dhe të klinikave përkatëse. Në të gjitha rastet e tjera duhet të mbahet në gjendje të heshtur.
- Respektimi i sekretit profesional është i detyrueshëm, ruajtja e konfidencialitetit të informacionit të përdoruesit dhe shkëmbimi i informacionit që i nënshtrohet intimitetit në rrjetet sociale.
- Është e ndaluar të fotografohen vendet dhe njerëzit.

Masat disiplinore

Sjellja e studentëve që i nënshtrohen masave disiplinore janë si më poshtë:

- Student potencialisht i rrezikshëm për sigurinë e pacientëve dhe/ose i cili ka përsëritur vazhdimisht gabime që rrezikojnë jetën e të tjerëve.
- Studenti që falsifikon nënshkrimin ose mban kartën identifikuese të një student tjetër.
- Shkelja që duhet të sanksionohet raportohet nga Koordinatori didaktik tek përgjegjësi i departamentit përmes një raporti. Ngjarja do të diskutohet dhe vlerësohet në një intervistë me studentin. Rekomandohet paraqitja në këshillin e etikës, i cili do të vazhdojë me formulimin e sanksionit disiplinor në përpyesëtim me entitetin e shkeljes.

Pezullimi jo-disiplinor nga praktika

- Studente shtatzënë.
- Student/e me probleme psikofizike që mund të shkaktojnë stres ose dëme për të sëmurët ose për ekipin e shërbimit ose që mund të pengojnë mundësinë e mësimin të aftësive kryesore profesionale të studentit.

KREU IV

VLERËSIMI I STUDENTIT

Neni 10

Vlerësimi i të nxënës

Përvoja e praktikës udhëhiqet nga plani i objektivave të praktikës dhe vlerësohet sipas kriterëve të përcaktuara në syllabusin e lëndës.

Vlerësimi i praktikës është një proces që kryhet nga Koordinatori didaktik profesionist në përfundim të të gjithë përvojës së vetë praktikës.

- Vlerësimi pozitiv i përvojës klinike përcaktohet kur studenti demonstroi se ai ka arritur kompetencat dhe aftësitë e kërkuara nga objektivat e vitit referues duke marrë aftësinë e duhur. Shkrimi i një raporti mbi praktikën pas përfundimit të saj është pjesë e vlerësimit të studentit me 25% të notës.
- Në rast se Mentori profesionist referon se studenti nuk e ka frekuentuar praktikën, atëherë orët e praktikës konsiderohen të pakryera.

Provimi i praktikës

Në përfundim të modulit, pedagogu i modulit/ lëndës vlerëson dhe vërteton përmes provimit me gojë kompetencat profesionale të arritura nga studenti duke u vlerësuar me 75% të notës.

Metodat dhe niveli i vështirësisë së provimit të praktikës klinike dhe ushtrimore miratohen në syllabusin e modulit dhe provimi duhet të përfshijë pyetje me gojë për vlerësimin e njohurive praktike të studentit.

Barrierë për provimin e praktikës

Studenti nuk mund të hyjë në provimin e praktikës:

- Nëse nuk e ka realizuar numrin e orëve të planifikuara të praktikës. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës.

Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën profesionale, departamenti mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në departament) mund t'i japë të drejtën për rikryerjen e praktikës deri në fund të vitit akademik.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 11

1. Praktika zhvillohet në institucionet e caktuara nga departamenti dhe fakulteti
2. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit dhe Rektori i UST-së.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.